



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “ERALD-G” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K36306784K, me seli: Dibër, Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61.

Procedura e prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-57477-01-30-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Loti Nr. 3: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Ndërtim i rrugës varrezat e qytetit - fshati Batër e Vogël, Bashkia Mat, Faza e I^{rë}”, me fond limit në vlerën: 193 761.06 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë zero gjashtë) lekë pa TVSH, nga granditë në vlerën: 31 261.06 (tridhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një pikë zero gjashtë) lekë pa TVSH, dhe nga të ardhurat në vlerën: 162 500 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, me afat realizimi: 5 (pesë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 12, datë 6 Shkurt 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L01717030C.

Vlera: 159 262.75 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

2. Operatori Ekonomik: “BN PROJECT” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L21305035S.

Vlera: **165 000** (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) **lekë pa TVSH**

3. Operatori Ekonomik: “ERALD-G” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K36306784K.**

Vlera: **159 705** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesë) **lekë pa TVSH**

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L01717030C.**

2. Operatori Ekonomik: “BN PROJECT” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L21305035S.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet situacioni i punimeve të ndërtimit i konfirmuar nga Autoriteti Kontraktor/Investitori për të cilin është kryer shërbimi i ngjashëm i mbikqyrjes për kontratën e paraqitur në procedurë.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se për kontratën e shërbimit të paraqitur nuk**

është paraqitur situacioni i punimeve të ndërtimit të konfirmuar nga Autoriteti Kontraktor/ Investitori për të cilin është kryer shërbimi i ngjashëm i mbikqyrjes.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.9 *Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përlllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”, si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”. Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se çmimi i ofertuar është nën vlerën e minimale të lejuar përlllogaritur në zbatim të VKM-së Nr.354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit” për këtë objekt prokurimi, ku si rrjedhojë bazuar në përcaktimet e nenit 7/1 të kësaj VKM-je oferta Juaj refuzohet.

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “BN PROJECT” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “a” dhe “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;...*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, dhe Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1.*

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.1, 2.2.2 dhe 2.2.3/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021, ku vlera e xhiros në të paktën*

I (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

2.2.3 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2022 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.*

➤ **Këto kushte nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur Vërtetim për xhiron vjetore, Bilancet vjetore, si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 në të cilin deklarohet se ka likujduar detyrimet për taksat vendore.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1 – 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

➤ **Këto kushte nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.9, si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 në të cilin deklarohet përmbushja e kriterëve 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 dhe 2.3.8.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “ERALD-G” Sh.p.k., me seli: *Dibër, Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61*, me numër Nipt-i: **K36306784K**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **159 705 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesë) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: *Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor